

KONKLuzionet Operacionale te Mbledhjes së Komitetit Shumepalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur

DATA: 11/11/2022

KRYESOHET: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standartet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

MBLEDHJA: No.1

ÇËSHTJET E DISKUTUARA:

Çështja Nr.1 *Hapja e mbledhjes dhe çështjet e diskutuara sipas agjendës/çështjeve për parashtrim*

Çështja Nr.2 *Prezantimi i Urdhrit të Kryeministrit mbi ngritjen e Komitetit, rolet dhe përgjegjësitë e tij, detyrat e sekretariatit, nevoja për përditësimin e anëtarëve bazuar në rolet dhe përgjegjësitë sipas akteve ligjore*

Çështja Nr.3 *Miratimi i bashkëkryetarit, përfaqësues i anëtarëve të KKSHC-së nga anëtarët e shoqërisë civile në Komitet dhe Kostituimi i Komitetit*

Çështja Nr.4 *Prezantimi i rolit të POC dhe përcaktimi i tij nga Komiteti*

Çështja Nr.5 *Kontributi në OGP i anëtarëve*

Çështja Nr.6 *Miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Komitetit*

Çështja Nr.7 *Diskutim mbi çështje të organizimit të punës së Komitetit (KSH të anëtarëve, mbledhjet, draft paraprak kalendari për Action Plan 2022-2024)*

Çështja Nr.8 *Çështje të tjera*

KONKLuzionet

1. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, deri në mbledhjen e radhës së Komitetit, përcaktojnë (zgjedhin) Bashkëkryetarin e Komitetit, sipas UKM;
2. Përmirësimi i Urdhrit të Kryeministrit, duke përfshirë edhe institucione të tjera shtetërore të lidhura me çështjen;

3. Rregullorja e funksionimit të Komitetit konsiderohet e miratuar në parim, priten komente (nëse ka) nga anëtarët e Komitetit;
4. Kërkesë drejtuar ministrive të linjës që të përcaktojnë një pikë kontakti për marrëdhëniet/komunikimin me shoqërinë civile, si dhe për OGP.